




Republika e Kosovës
Republika Kosova ~ Republic of Kosovo

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE ~ INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



VLERËSIMI I GATISHMËRISË SË QYTETARËVE PËR KALIMIN NË TRANSMETIMIN DIGJITAL



Implementuar nga:

Management
Development
Associates **MDA**
Developing Managers. Managing Development.

Prishtinë, Shtator 2013

Vërejtje

Këndvështrimet e paraqitura në këtë raport të hulumtimit mbi Vlerësimin e Gatishmërisë së Qytetarëve të Republikës së Kosovës për Kalimin në Transmetimin Digjital janë të autorit dhe jo domosdo përfaqësojnë ato të Komisionit të Pavarur për Media. Përmbajtja e raportit konsiderohet publike dhe mund të shpërndahet lirshëm.

Ekipi i projektit

Ekipi menaxhues:

Burim Leci, Menaxher i Projektit

Ylber Beqiri, Koordinator i Projektit dhe Kontrollues i cilësisë hulumtimit

Enver Gashi, Ekspert për Metodologji dhe Statistika

Personeli i angazhuar nga Komisioni i Pavarur për Media:

Liridon Dalipi, Recenzent si dhe Menaxher i Projektit

Përpiluesit e raportit:

Vera Rexhepi

Blendrit Elezaj

Kontrollerët e hulumtuesve në terren dhe sigurimi i cilësisë:

Kushtrim Gojani, Ylber Havolli, Merita Heta, Jeton Hajdari dhe Arbenita Alidema.

Procesimi kompjuterik i të dhënave statistikore:

Bardhyl Musa

Procesimi kompjuterik i pyetsorëve:

Arbenita Alidema, Jeton Hajdari, Qëndrim Jashari dhe Ylber Havolli

Hulumtuesit e angazhuar për hulumtimin në terren:

Prishtinë: Qëndrim Jashari, Arbër Jashari, Luljeta Gashi, Ermira Gashi, Granit Havolli, Kastriot Shabani, Blerta Sylja, Taulant Tmava, Granit Sogojeva

Drenas: Avdi Fejza, Ardita Heta

Podujevë: Blerim Shabani, Besnik Ejupi, Valon Aliu

Fushë Kosovë: Kaltrina Aliu, Ibrahim Sahiti

Lipjan: Katriot Shabani, Taulant Tmava, Arbër Jashari, Qëndrim Jashari

Gjilan: Marigona Shabiu, Liridon Rama, Delvina Rexhepi

Kamenicë: Besim Agaj, Amir Keka

Pejë: Linda Pajaziti, Fisnik Haxhija, Liridon Sahiti, Zana Aliu

Klinë: Esat Sahiti, Adnan Qupeva, Ardian Sadikaj, Liridon Sahiti

Istog: Esat Sahiti, Adnan Qupeva, Ardian Sadikaj, Liridon Sahiti

Junik: Kastriot Huli

Deçan: Albana Kastrati, Kushtrim Lajqi

Ferizaj: Diellza Beqiri, Fesim Avdiu, Blerta Sylja, Abetare Neziri

Kaçanik: Enis Mjaku, Asmir Dema

Shtime: Flamur Sallahu, Fitim Gashi

Hani i Elezit:	Enis Mjaku, Asmir Dema
Gjakova:	Nexhmedin Shala, Sadri Alija, Sebastian Krasniqi, Rilind Kusari
Mitrovicë- Jug:	Egzon Fejzullahu, Milivere Sogojeva, Albulena Hasani
Vushtrri:	Fitore Parduzi, Patriot Pllana, Sylejman Mehulli
Skenderaj:	Besnik Hajdini, Gani Veliu
Prizren:	Sellmir Rexha, Besarta Sopaj, Gzim Makshani, Lavdim Morina, Besart Gashi, Admir Shala
Suharekë:	Sellmir Rexha, Luan Ceku
Rahovec:	Haki Loshi, Fatih Sylka
Malishevë:	Refi Zogaj, Besart Gashi
Dragash:	Faton Zeka
Mitrovicë-Veri:	Jelena Vitkoviç, Ivana Milenkoviç
Klllokot:	Boban Petroviç
Leposaviq:	Jelena Milenkoviç,
Graçanicë:	Jovana Tanaskoviç, Tamara Trajkoviç, Sanja Ristiç, Katarina Stamenkoviç, Jovana
Shterpcë:	Maja Jovanoviç, Verica Jovanoviç
Partesh:	Jovan Rikalo
Zubin Potok:	Marija Lempaç

Përmbajtja

Ekipi i projektit	3
Përmbledhje ekzekutive	6
Të gjeturat kryesore	8
Hyrje	10
Informacionet bazë.....	10
Objektivat e Hulumtimit.....	10
Metodologjia e Hulumtimit	12
Karakteristikat e pjesëmarrësve në hulumtim	14
Shpërndarja e teknologjisë analoge dhe digjitale.....	14
Roli i televizionit në mënyren e jetesës.....	16
Pranimi i sinjalit.....	18
Përshtypjet mbi përmbajtjen programore të programeve televizive	21
Preferencat programore televizive.....	21
<i>Përshtypjet mbi përmbajtjen programore</i>	22
Vlerësimi i nivelit të informacioneve dhe edicioneve të lajmeve në televizionet lokale dhe nacionale.....	24
Vlerësimet e të anketuarve sa i përket ndryshimeve të nevojshme në programet e televizioneve lokale dhe nacionale.....	29
Vetëdijësimi dhe kuptimi i procesit të digjitalizimit	30
Niveli aktual i vetëdijësimit mbi procesin e digjitalizimit.....	30
Vetëdijësim mbi çfarë duhet bërë për procesin e digjitalizimit.....	33
Barrierat për të mbështetur kalimin	37
Qëndrimet ndaj benefiteve të antenës së thjeshtë	39
Qëndrimet ndaj kalimit në transmetim digjital	41
Segmenti 1: Tërësishtë gatshëm për kalimin	41
Segmenti 2: Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim por që mund të përgatiten lehtësisht.....	42
Segmenti 3: Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim dhe që mund të përgatiten me vështirësi....	42
Segmenti 4: Jo të gatshëm për kalim dhe që nuk e mbështesin kalimin në transmetim digjital....	43
Ndihmë shtesë për procesin e kalimit në transmetim digjital	44
Ndihmë financiare për procesin e digjitalizimit.....	44
Ndihmë teknime për procesin e digjitalizimit.....	44
Sfidat	46
Mungesa e njohurive mbi procesin	46
Sfidat financiare për përgatitje	47
Konkluzione dhe Rekomandime	49
Anekset	51
i. Shpërndarja e mostrës	
ii. Pyetësi	
iii. Raporti i detajuar statistikor	

Përmbledhje Ekzekutive

Informacione mbi Hulumtimin

Hulumtimi “Vlerësimi i gatishmërisë së qytetarëve për kalimin në transmetimin digjital” ka për qëllim të analizojë situatën dhe të ofrojë informata, që lidhen me procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor në Kosovë nga teknologjitë analoge në ato digjitale. Ky hulumtim ofron informata më specifike duke filluar nga karakteristikat e pjesëmarrësve në hulumtim (pronësia e televizioneve, roli i televizionit në mënyrën e jetësës, pranimi sinjalit televiziv, përshtypjet mbi përmbajtjet programore televizive, vetëdijësimin dhe kuptimin e procesit të digjitalizimit, qëndrimet në lidhje me kalimin në transmetim digjital digjital, ndihmën shtesë të nevojshme për këtë kalim si dhe sfidat e këtij tranzicioni). Gjithashtu, ky hulumtim identifikon një sërë elementesh me interes, siç janë gatishmëria socio-ekonomike për një kalim të tillë, aspekti fiziko-teknik dhe çështje të tjera të cilat janë të rëndësishme të përfshihen në procesin e kalimit nga transmetimi analog në transmetimin digjital, duke ndihmuar KPM për përcaktimin strategjik në këtë tranzicion.

Metodologjia e Hulumtit

Hulumtimi është realizuar me 3,480 të anketuar që jetojnë në Kosovë, të gjithë të moshës mbi 18 vjeç.. Anketa është realizuar kokë më kokë, me metodologji të intervistës me letër dhe laps ‘në shtëpinë’ e të anketuarit, sipas një mostre të rastësishme. Çdo pikë e mostrës u përpilua në mënyrë të tillë që të përfshijë familje pavarësisht nga lloji i vendbanimit urban ose rural. Ndarja e mostrës së hulumtit është bërë duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2011. Si mostër përfaqësuese për hulumtim është marrë 0.2% e numrit total të popullsisë, e cila rezulton me 95 % besueshmëri (niveli i konfidencës, dhe me një marzhe të gabimit prej 2% (intervali i konfidencës). Nga numri total prej 3480 respondentëve, mostra është e ndarë në 3152 respondentë shqiptarë që përbëjnë 91% të të intervistuarëve dhe 328 respondentë nga radhët e minoriteteve, pra 9%. Ndarja e mostrës është bërë në bazë të vendbanimit, ku 38% e të intervistuarëve jetojnë në zonat urbane dhe 62 % në zonat rurale. Gjithashtu, ndarja është bërë duke iu referuar regjistrimit të popullsisë në lidhje me gjininë dhe grupmoshat e caktuara, si më poshtë :

- Grup moshat: 18-28 = 42%; 29 -44 = 30%; 45-60 = 28%;
- Gjinia :Meshkuj = 50.34% dhe Femra = 49.66%.

Vetëdijësimi dhe kuptimi i televizionit digjital digjital

Procesi i kalimit në transmetim digjital digjital në Republikën e Kosovës, nuk është se është kuptuar dhe përhapur sa duhet tek qytetarët në të gjithë territorin e Kosovës.

Nga të intervistuarit tanë, 46.2% kanë deklaruar se nuk janë aspak të informuar për këtë proces dhe vetem 3.8% janë shumë të informuar, me shumicën e korrespondentëve të pozicionuar në anën e mungesës së informatave në lidhje me këtë proces.

Gjithashtu, mund të vërehet se pjesëmarrësit e anketimit nga zonat rurale duket të jenë më pak të informuar për procesin se sa pjesëmarrësit nga qytetet. 49.7% e tyre nuk janë aspak të informuar me procesin, për dallim me 40% të anketuarëve nga qyteti që kanë dhënë përgjigje të njëjtë.

Vetëdijësimi dhe kuptimi procesit të digjitalizimit

Lidhur me vetëdijësimin dhe kuptimin e procesit të digjitalizimit, KPM në vazhdimësi informon për aktivitetet gjatë gjithë procesit të digjitalizimit, si dhe bën sensibilizimin e opinionit dhe të organeve kompetente mbi ndryshimet që do të ndodhin gjatë procesit të digjitalizimit, në mënyrë që procesi të realizohet brenda afatit të planifikuar. Sidoqoftë, vetëdijësimi dhe kuptimi i procesit të digjitalizimit rezulton të jetë në një nivel që lë për të dëshiruar. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për më shumë informim sa i përket projektit për kalimin në transmetim digjital në Republikën e Kosovës, pasi një pjesë e madhe është shumë pak apo aspak e informuar mbi procesin. Megjithatë, shumica pajtohen që ky kalim është i nevojshëm.

Segmentimi i qëndrimeve

Të anketuarit e këtij hulumtimi mund të klasifikohen në katër segmente të ndryshme në bazë të nivelit të përgatitjes për kalimin në transmetim digjital. Kjo është bërë duke i krahasuar qëndrimet e tyre në lidhje me pyetjet e caktuara të cilat janë paraqitur në pyetësorin e hulumtimit (shih Aneks 1). Pas nxjerrjes së të dhënave, është gjetur se grupi më i madh i të anketuarëve gjendet në grupin i cili është pjesërisht apo jo i gatshëm për kalim, por që mund të përgaditet lehtësisht, me numër shumë më të vogël të atyre që janë plotësisht të gatshëm, dhe të tjerëve të cilët vështirë mund të përgatiten.

Grupi i cili përbëhet nga ata të cilët nuk janë të gatshëm dhe nuk e mbështesin kalimin në transmetim digjital është segmenti më i vogël i këtij hulumtimi.

Sfidat

Sfidat kryesore mbasin mungesa e njohurive mbi procesin e tranzicionit dhe sfidat financiare të qytetarëve për përgatitje-përgatitje. Pas nxjerrjes së të dhënave kemi vërejtur se është shumë e nevojshme rritja e njohurive të qytetarëve për çështjet teknike me të cilat duhet të merren për t'u përshtatur me kalimin në sistemin digjital. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarëve ka deklaruar se nuk janë të gatshëm të përballojnë financiarisht këtë tranzicion, gjë që mund të vështirësojë procesin.

Gjetjet kryesore

Në përgjithësi, gjetjet nga pyetëtorët tregojnë se qytetarët e Republikës së Kosovës kanë një qëndrim pozitiv për një tranzicion nga sistemi analog në atë digjital.

- 75.3% e të anketuarëve konsiderojnë që është i nevojshëm kalimi nga transmetimi analog në atë digjital digjital në Republikën e Kosovës, përderisa 17.7% shprehen se nuk e dinë nëse kjo është e nevojshme dhe vetëm 6.9% e kundërshtojnë një kalim të tillë. 25.9% e të anketuarëve janë shprehur se nuk e dinë se çfarë duhet të bëjnë në mënyrë që të përgatiten për këtë ndryshim.
- Ky hulumtim po ashtu ka evidentuar edhe barrierat kryesore lidhur me instalimin digjital të cilat ndër më të përmendurat janë mungesa e njohurive rreth instalimit digjital dhe të qenurit të kënaqur me sistemin e deritanishëm analog.
- Më shumë se gjysma e të intervistuarëve pranojnë sinjalin televiziv në mënyrë kabllore, ndërsa 31.4% në mënyrë tokësore, me atë kabllor të përhapur më shumë nëpër qytete (75.3%), dhe atë tokësor në fshatra (42.8%).
- Dy e treta e qytetarëve të Kosovës përdorin televizorë digjitalë, dhe vetëm një e treta është tashmë plotësisht e përgatitur për kalimin në transmetim digjital, pasi posedojnë televizorë digjital digjitalë.
- Televizionet nacionale, RTK, KTV dhe RTV21, janë televizionet më të pranuar përmes antenës së thjeshtë.
- Dy e treta e pjesëmarrësve preferojnë të blejnë resiverin për pranim të sinjalit dhe pjesa tjetër preferon blerjen e një televizori të ri. Kjo konfirmohet edhe më pas, kur një numër i përafërt deklaruar se kanë planifikuar blerjen e një televizori të ri në tre vitet e ardhshme, me shumicën duke paraqitur vitin 2015 si vitin kur do të bëjnë këtë blerje.
- Një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës (47.2%) shikojnë më shumë se dy orë program televiziv në ditë.
- Sipas korrespondentëve tanë, kanalet më të preferuara të tyre janë: KTV, e përmendur nga 1860 korrespondentë si kanal i tyre i preferuar, më pas RTK me 1714 responentë, dhe RTV21 e përmendur nga 1446 responentë. 2644 responentë përmendin lajmet, 1091 serialet, 983 filmat dhe 707 responentë përmendin sportin, si arsye kryesore pse preferojnë kanalet e tyre të preferuara. Po kështu, sipas 2087 responentëve RTK është kanali ku me se shumti shikojnë edicionet e lajmeve, pastaj KTV me 1858 responentët që kanë përmendur këtë kanal, ndërsa 995 responentë kanë përmendur që edicionet e lajmeve i shikojnë në kanalin RTV21.
- Pjesa më e madhe e qytetarëve qëndrojnë midis “mirë” dhe “shumë mirë” kur flitet për qëndrimet e tyre mbi cilësinë e përmbajtjes programore të kanaleve tona televizive. 73.2% e qytetarëve mendojnë se informatat në edicionet e lajmeve nga televizionet e preferuara janë “deri diku të sakta”, ndërsa sa i përket vlerësimit të informatave të ofruara nga televizionet lokale, pjesa më e madhe qëndron në mes të “kënaqshëm” dhe “mjaftueshëm”.

- Një e treta e qytetarëve do të fillonin të përdornin antenën e thjeshtë, me përmiresimin e transmetimit përmes saj, ndërsa pjesa tjetër do të vazhdojë me kabllorë apo ende nuk e di se çfarë do të vendosin.
- Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për më shumë informim sa i përket projektit për kalimin në transmetim digjital në Republikën e Kosovës, pasi një pjesë e madhe është shumë pak apo aspak e informuar mbi procesin. Megjithatë, shumica pajtohen që ky kalim është i nevojshëm.
- Një e katërta e të anketuarve nuk e dinë se çfarë duhet të bëjnë në mënyrë që të përgatiten për këtë kalim.

Hyrje

Informacionet bazë

Bazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka mandatin të përgatisë Strategjinë për kalim në transmetim digjital të Republikës së Kosovës si dhe dokumentet e tjera strategjike për shërbimet mediale audiovizuale. Në konferencën Gjeneva 2006, viti 2015 është përcaktuar si afat për kalimin në platformën digjitale për të gjitha shtetet antare të ITU-së, ku edhe Republika e Kosovës duhet të bëjë kalimin në transmetim digjital në këtë afat, pasi që pas 17 qershorit të vitit 2015 transmetimi analog nuk do të jetë i mbrojtur, përderisa për vendet e BE-së kalimi është parashikuar të bëhet në vitin 2012. Prandaj, KPM është duke punuar në Draft Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, “Kalimi i Transmetimit Analog në atë Digjital në Republikën e Kosovës”.

Në mesin e shumë përparësive, digjitalizimi do t’iu ofroj qytetarëve të Kosovës, cilësi më të mirë të pranimi të sinjalit televiziv, shumëllojshmëri më të madhe të përmbajtjes, më shumë programe televizive, shërbime të reja për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe për të moshuarit, shërbime shtesë, pranim portativ dhe mobil të programit, si dhe konvergencën e shërbimeve.

Plani për kompletimin e procesit të digjitalizimit pritet të perfundoj para datës 15 Qershor 2015, pas së cilës sistemi Analog do të shkyqet tërësisht dhe transmetimi digjital do të vihet në funksion. Gjatë kësaj kohe, qytetarët e Kosovës si dhe Kompanitë Mediale duhet të bëjnë kalimin e teknologjisë së pajisjeve të tyre transmetuese nga sistemi analog në atë digjital, kalim ky i cili kërkon sensibilizimin dhe përgatitjen e të gjitha grupeve të shoqërisë kosovare. Ky Raport është përgatitur bazuar në hulumtimin e dizejnuar për të vlerësuar gatishmërinë e qytetarëve sa i përket këtij tranzicioni, dhe kompania MDA (Management Development Associates) është përzgjedhur nga KPM për të realizuar këtë hulumtim.

Objektivat e Hulumtimit

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

- Rritja e vetëdijes dhe të kuptuarit e komunitetit për televizionin digjital dhe kalimit në programet digjitale televizive, duke përfshirë nga momenti kur fillon dhe çfarë konsumatorët duhet të bëjnë për tu përgatitur;
- Identifikimi i barrierave dhe/ose motivuesve në përmirësimin e njohurive dhe të kuptuarit e çështjeve të kalimit, duke përfshirë se si të përgatiten për kalim; dhe
- Përcaktimi sa më i përshtatshëm i mesazheve, toneve dhe kanaleve të komunikimit në mënyrë efektive për të rritur ndërgjegjësimin dhe motivimin e konsumatorëve që të kërkojnë informacion të mëtejshëm në lidhje me skemat e mundshme të kalimit.

Ky hulumtim gjithashtu mundëson KPM-në dhe palët tjera të interesuara të kuptojnë:

- Nivelin aktual të vetëdijesimit dhe sensibilizimit të qytetarëve mbi procesin e digjitalizimit;

- Mundësitë financiare dhe ato teknike të qytetarëve të Kosovës për kalimin në sistemin digjital;
- Identifikimi apo segmentimi i grupeve të qytetarëve nga ata tërësisht të gatshëm për kalimin në sistemin digjital deri tek ata jo të gatshëm dhe që nuk e mbështesin kalimin në transmetim digjital;
- Zhvillimi i një strategjie më të përshtashme për nevojat aktuale të qytetarëve; si dhe identifikimi i aktiviteteve, për shembull fushatave që do ta lehtësonte këtë proces.

Metodologjia e Hulumtimit

Hulumtimi “Gatishmëria e Qytetarëve për pranimin e sinjalit Digjital në Kosovë” u realizua për të identifikuar gatishmërinë dhe njohuritë që kanë qytetarët e Kosovës mbi sistemin e digjitalizimit në Kosovë, hulumtimi është realizuar me 3,480 të anketuarve, të gjithë të moshës 18 vjeç ose më të vjetër dhe që jetojnë në Kosovë. Anketa u realizua kokë më kokë, me metodologji të intervistës me letër dhe laps ‘në shtëpinë’ e të anketuarit, me mostrën e rastësishme. Çdo pikë e mostrës u dizajnuar që të përfshijë familje pavarësisht nga lloji i vendbanimit urban ose rural.

Selektimi i familjeve për anketim në kuadër të çdo pike të mostrës u bazua në metodën e ‘rastësishme’. Në zonat rurale familja e parë e kontaktuar ishte shtëpia e tretë/numri i adresës nga pika fillestare e anës së majtë të rrugës, dhe çdo shtëpi e dytë pas asaj familjeje. Nëpër blloqe të banesave, familja e zgjedhur ishte çdo banesë e tretë, duke numëruar nga i pari i çdo ndërtese.

Në familjen e zgjedhur për anketim, është përzgjedhur vetëm një person i moshës 18 vjeç ose më i vjetër duke pyetur ditëlindjet e anëtarëve të familjes dhe duke zgjedhur personin, ditëlindja e të cilit ishte (e para) më e përafërt me datën e intervistës. Gjithsej u realizuan 3,480 intervista kokë më kokë.

Ndarja e mostrës është bërë duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2011. Ndërsa 0.2 përqind e numrit total të popullsisë është marrë si mostër përfaqësuese për hulumtim, e cila rezulton me 95 përqind besueshmëri (niveli i konfidences, dhe me një marzhe të gabimit prej +/-2 përqind (intervali i konfidences). Nga numri total prej **3480 i respondentëve**, mostra është e ndarë në **3152 respondentë shqiptarë** apo 91 përqind dhe **328 respondentë nga radhët e minoriteteve** apo 9 përqind.

Ndarja e mostrës në bazë të vendbanimit është bërë si në vijim, gjithnjë duke iu referuar regjistrimit të popullsisë: 38 përqind në zonat urbane dhe 62 përqind në zonat rurale. Gjatë hulumtimit, mostra është ndarë në pikënisje të ndryshme përbrenda qyteteve si fshatrave të ndryshme të qytetevepërkatese.

Mostra është ndarë në përqindje të gjinisë dhe grupmoshave, gjithnjë duke ju referuar regjistrimit të popullsisë:

- Grup moshat: 18-28 = 42 përqind; 29 -44 = 30 përqind; 45-60 = 28 përqind;
- Gjinia e ndarë në Meshkuj = 50.3 përqind dhe Femra = 49.6 përqind¹.

Fillimisht në konsultim me zyrtarët e KPM-së, ekipi nga MDA ka hartuar pyetësorin i cili siguron përmbushjen e qëllimit të hulumtimit. Më pas është realizuar një trajnim për

¹ Gjatë realizimit të hulumtimit kishte divijim nga mostra në disa pjesë demografike deri në masën maksimale 4% dhe e cila nuk ka ndikuar në validitetin statistikor.

intervistuesit nga eksperti i hulumtimeve mbi përmbajtjen e pyetësorit dhe mostrës për secilën komunë.

Pas trajnimit është pilotuar një numër prej gjithsej 50 pyetësore në të gjitha komunitat, duke u siguruar se pyetësori është i kuptueshëm për të gjitha shtresat dhe gjithashtu përmbush nevojat e hulumtimit. Pas përfundimit të punës në terren një grup regjistrueshish për futjen e të dhënave në SPSS janë trajnuar nga eksperti i statistikës me qëllim që të dhënat të jenë të sakta.

Të gjitha analizat statistikore dhe përpunimi i të dhënave janë realizuar duke përdorur softuerin SPSS (Pakoja Statistike për Shkencat Sociale).

Mosta e ndarë sipas përqindjes së demografisë:

Numri total i respondenteve	Gjinia		Zona		Etniciteti		Grup mosha		
	Meshkuj	Femra	Urban (qytet)	Rural (fshat)	Shqiptar	Të tjerë	18 - 28	45-65	29-44
3,480	50.3%	49.6%	38%	62%	91%	9%	42%	30%	28%

Karakteristikat e pjesëmarrësve në hulumtim

Përsa i përket karakteristikave të pjesëmarrësve në hulumtim, katër elemente janë konsideruar si më të rëndësishme për t'u veçuar dhe analizuar si: pronësia e aparateve televizive, roli i televizionit në mënyrën e jetesës, pranimi i sinjalit si dhe profili demografik i pjesëmarrësve.

Shpërndarja e teknologjisë analoge dhe digjitale

Në pyetjen se çfarë lloji të televizorit zotëroni, sa i përket zotërimit të aparateve dhe llojit të pajisjeve televizive, 64.1% e të anketuarve posedojnë TV Analog kurse 35.5% posedojnë TV Digital (DVB-T2, MPEG-4).




Figura 1: Llojet e pajisjeve televizive e të anketuarve – televizorët analog dhe digjital

Dallimi më i madh të lloji i pajisjeve televizive qëndron në mes të grupeve etnike serbe, boshnjake dhe RAE (Fig.2), si dhe të anketuarëve që sipas statusit të punësimit janë kategorizuar si të papunë dhe atyre të paaftë për punë (Fig.3).




Figura 2. Çfarë lloji të televizorit posedoni-ndarja sipas grupit etnik.




Figura 3: Çfarë lloji të televizorit posedoni - ndarja sipas statusit të punësimit.

Procesi i kalimit nga transmetimi analog në atë digjital, gjithashtu, kërkon një kosto shtesë për qytetarët, për t'u pajisur me një pranues (resiver) për sinjal digjital. Lidhur me gatishmërinë për shpenzime financiare për blerjen e pajisjeve si resiverit për pranim sinjali (me kosto të përafert prej €30 - €50) apo të blerjes së aparatit televiziv të ri, 65.4% e të anketuarve janë përgjigjur se janë të gatshëm për të blerë resiver për pranimin e sinjalit, kurse 34.6% do të blinin TV të ri.




Figura 4: Preferencat për blerjen e resiverit për pranim sinjali (me kosto të përafërt prej 30-50 euro) apo blerja e TV të ri.

Nga grafiku i paraqitur në vazhdim, shihet se tek të gjitha grupet si ata të punësuar, të papunë, pensionistë, studentë apo edhe ata të paaftë për punë, preferojnë që të pajisen me resiver për pranim sinjali me një kosto të përafërt 30 -50 euro përkundër blerjes së një TV të ri që do të kushtojë një shume më të madhe, duke dhënë si indikacion se shpenzimet financiare mund të jenë një barrierë në tranzicionin nga sistemi analog në sistemin digjital.




Figura 5: Preferencat për blerjen e resiverit për pranim sinjali (me kosto të përafërt prej 30-50 euro) apo blerja e TV të ri - ndarja e të anketuarve sipas grupit etnik.

Roli i televizionit në mënyrën e jetesës

Nga hulumtimi shihet se përcjellja e programeve televizive luan një pjesë mjaft të rëndësishme në aktivitetet ditore të qytetarëve, 47.2% e të anketuarve deklarojnë se mesatarisht në ditë shohin mbi 2 orë televizor, si dhe 33.3% shohin 1 deri 2 orë program televiziv. Në aspektin gjinor kemi pothuajse rezultate të përafërta, por me shikueshmëri më të lartë udhëheqin grupmosha e pensionistëve (53.79%), të papunëve (51.3%) dhe

studentëve (48.6%). Vetëm 5.2% e të anketuarve shikon program televiziv për më pak se 30 minuta.




Figura 6: Koha mesatare e shikimit te televizionit në ditë.




Figura 7: Koha mesatare e shikimit te televizionit në ditë - ndarja e të anketuarve sipas statusit të punësimit.

Sa i përket kohës se kur ka më shumë shikueshmëri televizioni, hulumtimi tregon se koha kur më së shumti ndiqen ekranet televizive është mbrëmja (81.4% e të anketuarve), ndërsa koha kur më së paku ndiqet është pas mesnate (2.9%) dhe paradite (5.9%).




Figura 8: Në çfarë kohe të ditës ndiqni më tepër ekranin televiziv?

Nje shifër e njëjtë e përcjellshmërisë të lartë e programeve në kohë të mbrëmjes vërehet edhe në zonat qytet 81.4% dhe fshat 81.3%.




Figura 9: Në çfarë kohe gjatë ditës ndiqni më tepër ekranin televiziv- ndarja sipas zonave qytet dhe fshat.

Pranimi i Sinjalit

Sa i përket mënyrës së pranimiit të sinjalit televiziv, 51.4% e të anketuarve posedojnë sinjalin televiziv kabllor, duke lënë në vend të dytë atë tokësor 31.4% dhe satelitor 14.4%.




Figura 10: Në çfarë mënyre pranoni sinjalin televiziv?

Rezultatet nga terreni tregojnë se 75.3% e të anketuarëve në zonat afër qendrës dhe periferike marrin sinjal televiziv kabllor, derisa në fshatra kjo përqindje zbret në 35.4%.




Figura 11: Në çfarë mënyre e pranoni sinjalin televiziv - ndarja sipas zonave qytet dhe fshat.

Zonat nëpër fshatra kryesisht udhëheqin në marrjen e sinjalit përmes rrjetit tokësor 43.1%, satelitor 18.5% dhe përmes internetit (pranimi i sinjalit përmes internet routerit), përderisa zonat nëpër qendra dhe periferi kryesisht pranojnë sinjalin kabllor. Sa i përket IPTV (percjellja e kanaleve dhe programeve në smartphone, kompjuter apo tabletë përmes internet) shihet një shifër e ulët e përdorimit në të tri zonat, qytet 0.8%, periferi 0.2% dhe fshat 0.1%.

Një përdorim më i lartë i pranimi të sinjalit televiziv nga rrjeti kabllor shihet edhe nga komunitetet jo shumicë në Kosovë. 84% e komunitetit serb pranon sinjalin televiziv përmes rrjetit kabllor, përderisa përmes rrjetit tokësor sinjalin televiziv e pranojnë vetëm 5% prej tyre, dhe atë satelitor 5.9%. Edhe komuniteti RAE ka një përdorim më të shfaqur të rrjetit kabllor 71.2%, krahasuar me rrjetin tokësor 19.2%.




Figura 12: Në çfarë mënyre e pranoni sinjalin televiziv - ndarja sipas grupit etnik.

Përshtypjet mbi përmbajtjen programore të programeve televizive

Preferencat programore televizive

Sa i përket kanaleve televizive më të preferuara dhe arsyeve për një preferencë të tillë, sipas respondentëve kanalet më të preferuara të tyre janë: KTV është përmendur nga 1860 respondentë si kanali i tyre i preferuar, më pas prej 1714 respondentëve është përmendur RTK-ja si kanal i tyre i preferuar, ndërsa RTV 21 është përmendur nga 1446 respondentë si kanal i tyre i preferuar.




Figura13: Kanalet më të preferuara televizive.

Ndër arsyet pse të anketuarit i preferojnë këto kanale, 2644 të anketuar përmendin edicionet e lajmeve, 1091 i preferojnë për shkak të serialeve, 983 të anketuar pëlqejnë ato kanale për shkak të filmave, ndërsa 707 të anketuar përmendin sportin.




Figura 14: Programet më të preferuara – sipas përmbajtjes programore.

Pershtypjet mbi përmbajtjen programore

Sipas preferencave gjinore, programet më të shikuara për gjininë femërore janë programet argëtuese 49.6%, emisionet e lajmeve 25.7%, dhe ndër ato që i përcjellin më së paku rezultojnë emisionet sportive me 1.8%. Përdërisa, gjinia mashkullore përcjellin më së shumti emisionet e lajmeve 41.3%, emisione sportive 25.3%, ndërsa më së paku përcjellin debatet televizive 7.7% dhe emisione të tjera 4.5%.




Figura 15: Programet që shikohen më së shumti sipas ndarjes gjinore.

Nga të anketuarit në përgjithësi programet që përcillen më së shumti janë edicionet e lajmeve 34.5%, programet argëtuese 29.3%, dhe programet sportive 15.1%.




Figura 16: Programet që shikohen më së shumti

Hulumtimi tregon se grup moshat më të mëdha kanë një preferencë më të madhe ndaj programeve si dhe edicioneve të lajmeve, kurse moshat e reja tek programet argëtuese dhe sporti.




Figura 17: Programet që shikohen më së shumti – ndarja sipas grupmoshave.

Lidhur me vlerësimet e të anketuarve për përmbajtjen programore të kanaleve televizive në vendin tonë, 49.8% e konsiderojnë si të mirë dhe 30.9% e konsiderojnë si shumë të mirë. 9.7% e konsiderojnë përmbajtjen programore si të dobët.




Figura 18: Vlerësimet për përmbajtjet programore të kanaleve televizive vendore.

Vlerësimet për përmbajtjet programore televizive nuk kanë shumë dallime në mes të gjinive dhe zonave fshat-qytet. Ndërsa sa i përket grupeve etnike, komuniteti turk, boshnjak dhe RAE japin vlerësim më pozitiv për përmbajtjet programore të kanaleve televizive vendore.

Tabela 1: Vlerësimet për përmbajtjet programore të kanaleve televizive vendore sipas gjinisë, moshës, zonave dhe grupit etnik.

	Gjinia:		Zona:			Grupi Etnik:				
	F	M	Qytet	Fshat	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	RAE	Tjetër
Shkëlqyeshëm	8.8%	6.2%	8.1%	7.0%	7.7%	6.2%	16.7%	2.9%	1.9%	2.3%
Shumë mirë	32.2%	29.8%	27.7%	32.7%	29.9%	34.3%	25.0%	18.6%	63.5%	44.2%
Mirë	49.3%	50.1%	50.8%	49.0%	50.5%	42.6%	58.3%	65.7%	32.7%	51.2%
Dobët	7.0%	11.9%	11.7%	8.6%	10.2%	8.0%	0.0%	11.4%	1.9%	2.3%
Nuk kam pergjigje	2.7%	2.1%	1.7%	2.8%	1.7%	8.9%	0.0%	1.4%	0.0%	0.0%
Refuzoj	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

Vlerësimi i nivelit të informacioneve dhe edicioneve të lajmeve në televizionet lokale dhe nacionale

Pyetjes se në cilat kanale televizive i përcjellin edicionet e lajmeve, sipas 2087 respondentëve, RTK-ja është kanali ku më së shumti përcillen edicionet e lajmeve, pastaj KTV me 1858 të anketuar që kanë përmendur këtë kanal, ndërsa 995 respondentë kanë përmendur që edicionet e lajmeve i shikojnë në kanalin TV 21.




Figura 19: Përcjellja e edicioneve të lajmeve sipas kanaleve televizive.

Edicionet informative të lajmeve nga televizionet e preferuara të anketuarve konsiderohen deri diku të sakta nga 73.2% e të anketuarve, 14.8% i konsiderojnë si shumë të sakta dhe 5.9% aspak të sakta. Përgjigje me përqindje të përafërta janë dhënë nga të anketuarit pavarësisht nga zona, mosha apo grupi etnik.




Figura 20: Saktësia e informatave në edicionet e lajmeve nga televizionet e preferuara.

Të gjitha grupet etnike, saktësinë e informatave në edicionet e lajmeve nga televizionet e preferuara e kanë vlerësuar si deri diku të saktë (shqiptarët 73.7%, komuniteti serb 64.8%, komuniteti turk 75%).




Figura 21: Saktësia e informatave në edicionet e lajmeve nga televizionet e preferuara – ndarja e të anketuarve sipas grupit etnik.

Vlerësimi i përgjithshëm i informatave të ofruara nga televizionet lokale konsiderohet kryesisht si i mjaftueshëm. Informatat që ofrohen nga televizionet lokale, vlerësohen si të kënaqshme 33.3% dhe të mjaftueshme nga 31.1%, kurse përgjigje kanë refuzuar të japin 12.2% e të anketuarëve.




Figura 22: Vlerësimi i përgjithshëm i informatave nga televizionet lokale.

Një nivel pothuajse i njëjtë i vlerësimit të informatave që ofrohen nga televizionet lokale dominon si tek të anketuarit nga qyteti po ashtu edhe nga fshati. Në qytete ky informim është konsideruar si i kënaqshëm nga 32.5% dhe i mjaftueshëm nga 34.6%, kurse në fshatra i kënaqshëm 33.2% dhe mjaftueshëm 28.9%.




Figura 23: Vlerësim i përgjithshëm i informatave nga televizionet lokale – ndarja e të anketuarve sipas zonave qytet dhe fshat.

Të ndarë sipas etnicitetit, komuniteti serb (48.2%), komuniteti RAE (48.1%) dhe ai turk (41.7%) shprehen si të kënaqur me informatat qe ju ofrohen nga televizionet lokale, ndërsa komuniteti shqiptar 32.1%, boshnjakë 11.8% dhe të tjerë 8.9%.




Figura 24: Vlerësimi i përgjithshëm i informatave të ofruara nga televizionet lokale.

Sa i përket vlerësimit të informatave të ofruara nga televizionet nacionale (RTK, KTV, 21) televizionet nacionale në aspektin e ofrimit të informacionit, janë vlerësuar në nivel të kënaqshëm nga 45.9% e të anketuarve dhe në nivel të mjaftueshëm 32.5%, ndërsa 4.7% e të anketuarve e ka vlerësuar si të pamjaftueshëm nivelin e informacionit nga televizionet nacionale.




Figura 25: Vlerësimi i informatave nga televizionet nacionale (RTK, KTV, TV21).

Grupet etnike edhe në nivelin nacional, informatat e ofruara nga televizionet nacionale (RTK, KTV, 21) i vlerësojnë si të shkëlqyeshme (shqiptar 9.3%, serb 13%, turk 16.7%, boshnjak 4.3%, RAE 11.5% dhe grupe tjera 14%); të kënaqshme (shqiptar 44.7%, serb 59.9%, turk 41.7%, boshnjak 45.7%, RAE 51.9% dhe grupe të tjera 51.2%); Nën 10% e të gjitha grupeve etnike vlerësojnë këto informata si të pamjaftueshme dhe të dobëta.




Figura 26: Vlerësimi i informatave nga televizionet nacionale (RTK, KTV, TV21) - ndarja e të anketuarve sipas grupit etnik.

Vlerësimet e të anketuar ë ve sa i perket ndryshimeve te nevojshme n ë programet e televizioneve lokale dhe kombëtare

Ndryshimet e propozuara në programet e televizioneve lokale dhe nacionale sipas shumicës së të anketuarve janë sipas renditjes në tabelën më poshtë:

Tabela 2: *Ndryshimet e propozuara për programet e televizioneve lokale dhe nacionale.*

Sipas vlerësimit tuaj, çfarë ndryshime do të propozonit në programet e televizioneve lokale dhe nacionale?

Përgjigjet:	
1	Më shumë sport
2	Më shumë emisione argëtuese
3	Më shumë muzike
4	Më shumë emisione edukative
5	Më shumë informacione te sakta
6	Më shumë filma të rinj
7	Me pak seriale
8	Më shumë gazetari hulumtuese
9	Më shumë programe per femije
10	Më shumë dokumentar
11	Më shumë seriale vendore

Vetëdijësimi dhe kuptimi i procesit të digjitalizimit

Niveli aktual i vetëdijësimit mbi procesin e digjitalizimit

Vetëm 3.8% e të anketuarëve e konsiderojnë veten si shumë të informuar për procesin e kalimit në transmetim digjital të Republikës së Kosovës, 27.5% janë pak të informuar ndërsa aspak të informuar janë rreth 46% e të anketuarëve. Një dallim i lehtë qëndron në mes të anketuarëve nga zonat urbane dhe rurale, ku ata nga zonat urbane rezultojnë pak më të informuar, si dhe tek grupet etnike komuniteti shqiptarë del si më i informuari, kurse më pak ai boshnjak.




Figura 27: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital në Republikën e Kosovës.

Të ndarë sipas gjinisë, grupmoshës dhe zonave, të anketuarit shprehen në përgjithësi të pak informuar apo aspak të informuar për procesin e kalimit në transmetimin digjital të vendit tonë. Të informuar pak janë 27.8% e femrave kurse aspak të informuar 49.3% e tyre, ndërsa mashkujt të informuar pak janë 27.2% kurse aspak të informuar janë 43.8%. Nëpër qytete ekziston një shkallë pak më e lartë informimi se në fshatra (shih Tabela 3.)

Tabela 3: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital në Republikën e Kosovës - ndarja sipas gjinisë, moshës dhe zonave.

	Gjinia:		Moshë:				Zona:	
	F	M	18 – 28	29 – 44	45 – 65	mbi 65	Qytet	Fshat
Shumë i/e informuar	3.0%	4.4%	4.3%	4.3%	2.7%	1.9%	3.9%	3.8%
Deri diku i/e informuar	14.8%	20.4%	19.9%	16.9%	17.1%	11.2%	21.5%	15.7%
Pak i/e informuar	27.8%	27.2%	30.1%	28.7%	23.7%	12.1%	29.1%	25.9%
Aspak	49.3%	43.8%	42.0%	45.0%	51.2%	67.3%	41.7%	49.5%
Nuk e di	5.1%	4.2%	3.6%	5.1%	5.2%	7.5%	3.8%	5.2%

Sa i përket aspektit gjinor, nuk ka dallime të mëdha në nivelin e informimit. Për një përqindje të vogël duket se femrat janë pak më pak të informuara në përgjithësi për kalimin në krahasim me meshkujt:




Figura 28: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital ne Republikën e Kosovës – ndarja sipas gjinise

Në aspektin e moshës, të moshuarit janë më të painformuarit në lidhje me procesin, ndërsa të rinjtë prej 18 deri 28 vjet gjenden më mirë me njohuritë mbi këtë proces.




Figura 29: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital ne Republikën e Kosovës – ndarja sipas grupmoshave

Edhe pse jo aq dallim i theksuar, qytetet janë më të informuara në lidhje me projektin e kalimin të transmetim digjital se sa të anketuarit nëpër fshatra.




Figura 30: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital ne Republikën e Kosovës – ndarja sipas zonave qytet/fshat

Kur flitet për nivelin e njohurisë mbi këtë proces në krahasime etnike përbrenda grupit të intervistuarëve, shqiptarët janë më të informuarit, kurse ndër ata që janë përgjigjur me “aspak të informuar” më së shumti janë boshnjakët me 71.4% dhe RAE me 57%.




Figura 31: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital ne Republikën e Kosovës – ndarja sipas etnicitetit

Nuk vërehet ndonjë dallim i theksuar në nivelin rajonal, pasi përqindjet e secilit opsion të përgjigjeve janë shumë të përafërta.




Figura 32: Shkalla e informimit për procesin e kalimit në transmetimin digjital ne Republikën e Kosovës – ndarja ne nivel rajonal

Vetëdijësim mbi çfarë duhet bërë për procesin e digjitalizimit

25.9% e të anketuarve nuk e dinë fare se çfarë duhet bërë si përgatitje për ndryshimin nga sistemi analog në digjital, 27.9 % mendojnë se duhet blerë një resiver digjital, dhe 22.9% konsiderojnë se për përgatitje duhet blerë një TV digjital. Përgjithësisht, vërehet një dallim i lehtë më pozitiv në nivelin e njohurive lidhur me përgatitjet e nevojshme tek të punësuarit, studentët dhe të anketuarit nga zona urbane.




Figura 33: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital

Përgjithësisht, vërehet një dallim i lehtë me pozitiv në nivelin e njohurive lidhur me përgatitjet e nevojshme tek të punësuarit, studentët dhe të anketuarit nga zona urbane.




Figura 34: Vlerësimi për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital - ndarja e të anketuarve sipas statusit të punësimit

Po ashtu nuk ka dallime të mëdha në mes të përgjigjeve të femrave dhe meshkujve të anketuar në lidhje me këtë pyetje. Megjithatë, gati 8% më shumë femra se sa meshkuj janë përgjigjur se nuk e dinë se çfarë duhet bërë që të përgaditen për këtë ndryshim.




Figura 35: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital – ndarja sipas gjinise

Me “Nuk e di” më së shumti janë përgjigjur grupmoshat mbi 65 vjeç, ndërsa më së paku ata 18 deri 28. Më të informuarit për aspektet teknike janë me të rinjtë, me uljen e

njohurisë teknike paralel me ngritjen në moshë. Vlen të përmendet se ata mbi moshën 65 vjeçare janë grupi që më shumti janë deklaruar se nuk kanë nevojë që të bëjnë asgjë për t’u përgatitur për tranzicionin.




Figura 36: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital – ndarja sipas grupmoshes

Boshnjakët, të përcjellur nga grupet “e tjera” etnike dhe më pas serbët janë grupet që më shumti i janë përgjigjur kësaj pyetje me “nuk e di”. Gjithashtu, më së shumti serbë kanë thënë që nuk kanë nevojë të bëjnë asgjë për t’u përgatitur.




Figura 37: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital – ndarja sipas etnicitetit

Zonat urbane dhe ato rurale nuk kanë dallime të mëdha në atë se çfarë duhet të bëjnë për përgatitje. Përgjigjet janë përafërsisht të ngjashme për të dyja grupet.




Figura 38: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital – ndarja sipas zonave qytet/fshat




Figura 39: Vlerësimet për përgatitjet e nevojshme për kalimin nga sistemi analog në atë digjital – ndarja sipas rajoneve

Barrierat për të mbështetur kalimin

Lidhur me pyetjen se cilat janë barrierat për të mbështetur kalimin ne sistemin digjital, të anketuarit nga ky hulumtim, si barriera kryesore të instalimit digjital kanë renditur:

- njohuritë e pamjaftueshme rreth instalimit digjital 24.1%
- nuk është prioritet në listën prioritare të tyre 22.8%,
- ky instalim është shumë i shtrenjtë për ata 13.1%,
- të qenit të knaqur me sistemin e deri-tanishëm 10.6%, dhe
- mosgatishmëria për të shpenzuar më shumë në TV 6.4 %.

Më poshtë mund të shihni përgjigjet për këtë pyetje për grupe të ndryshme moshore. Prapë, janë ata të moshës 65+ të cilat kanë më pak njohuri rreth instalimit digjital dhe për të cilët instalimi është shumë i shtrenjtë, percjellur nga grupi moshor 45-65. Për të rinjtë e moshës 18 deri 28, barrierat kryesore në të cilat përgjigjet e tyre dallojnë më shumë është qe instalimi nuk është prioritet për ta, janë të kënaqur me sistemin e deritanishëm, apo si për shumë të tjerë, nuk kanë njohuri të mjaftueshme rreth saj.




Figura 40: Barrierat kryesore lidhur me instalimin digjital – ndarja sipas grupmoshave.

Pjesëmarrësit nga fshatrat, në krahasim me ata nga qytetet, kanë më pak njohuri për instalimin digjital dhe mendojnë se instalimi është shumë i shtrenjtë për ta. Ky instalim është me më pak prioritet për pjesëmarrësit nga qytetet, të cilët janë poashtu grupi më shumë i kënaqur me sistemin e tanishëm.




Figura 41: Barrierat kryesore lidhur me instalimin digjital – ndarja sipas zonave fshat-qytet.

Ky instalim konsiderohet shumë i shtrenjtë më shumë për pjesëmarrësit nga Rajoni i Pejës dhe i Gjakovës. Vërehen shkallë të larta të mungesës së njohurive për instalimin në zonën e komunave serbe dhe në rajonin e Prishtinës. Prizeni dhe Ferizaji, dallojnë nga rajonet e tjera. Për qytetarët e rajonit të Mitrovicës ky instalim nuk është prioritet, shumë më pak se në rajonet tjera. Për më shumë, shihni përgjigjet e kësaj pyetje në kontekst rajonal:




Figura 42: Barrierat kryesore lidhur me instalimin digjital - ndarja e të anketuarve sipas rajoneve.

Qëndrimet ndaj benefiteve të antenës së thjeshtë

Anketuesit, të njoftuar me faktin se pas kalimit në transmetim digjital do të shohin më shumë kanale televizive me sinjal shumë më të mirë përmes antenës së thjeshtë, janë pyetur nëse do të vazhdonin ende me kabllor apo do të merrnin shërbime përmes antenës së thjeshtë. 32.2% janë shprehur se do të vazhdojnë përdorimin e kabllorit, ndërsa 39.1% janë shprehur se do të përdorin antenë të thjeshtë, ndërsa një përqindje mjaft e madhe 24.2% shprehet e pavendosur se çfarë do të bëjë.




Figura 43: Preferencat ndaj shërbimit kabllore dhe atij përmes antenës së thjeshtë.

Komunat serbe shprehin më së shumti pasiguri në këtë pyetje, pasi numri i atyre që janë përgjigjur me “nuk e di” dallon shumë nga rajonet e tjera.




Figura 44: Preferencat ndaj shërbimit kabllore dhe atij përmes antenës së thjeshtë - ndarja e të anketuarve sipas rajoneve.

Qëndrimet ndaj kalimit në transmetim digjital

Segmentimi i qëndrimeve

Ky kapitull adreson qëndrimet e pjesëmarrësve të hulumtimit ndaj kalimit në transmetim digjital. Gjithashtu bëhet diskutimi i sjelljes së parashikuar të pjesëmarrësve në lidhje me përgatitjen për tranzicionin.

Hulumtimi ka zbuluar se një numër i madh faktorësh të rëndësishëm ndikojnë në nivelin e mbështetjes dhe gatishmërisë së qytetarëve për t'u përgatitur për televizionin digjital:

- Niveli aktual i përgatitjes;
- Niveli i ndërgjegjësimit dhe i njohurive për teknologjinë digjitale dhe procesin e digjitalizimit
- Shpenzimet që lidhen me kalimin
- Shkalla e shikueshmerisë së televizionit
- Roli i televizionit në mënyrën e jetesës së pjesëmarrësve – nëse mirret si nevojë apo jo
- Kualiteti i pranimit të sinjalit dhe qasja në kanale televizive.

Hulumtimi identifikon katër grupe të qëndrimeve të pjesëmarrësve në lidhje me mbështetjen dhe gatishmërinë për t'u përgadit për kalimin në transmetim digjital:

- Segmenti 1:** Kompletisht të gatshëm për kalimin;
- Segmenti 2:** Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim por që mund të përgaditen lehtësisht;
- Segmenti 3:** Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim dhe që mund të përgaditen më veshtirësi;
- Segmenti 4:** Jo të gatshëm për kalim dhe nuk e mbështesin Kalimin në Transmetim Digjital;

Segmenti 1: Kompletisht të gatshëm për kalimin

Pjesëmarrësit në segmentin 1 janë plotësisht të gatshëm për kalimin në transmetim digjital – ata tashmë kanë televizorë digjital apo pajisje të transmetimit digjital.

Pjesëmarrësit e Segmentit 1 kanë qenë individë të cilët:

- Kanë televizorë digjital;
- Nuk kanë nevojë të bëjnë asgjë në menyrë që të përgaditen për kalimin nga transmetimi analog në atë digjital;
- Kanë raportuar shkallë të lartë të shikueshmerisë.

Pas tabulimit të të dhënave, është gjetur se 217, apo 6.23% e të anketuarve në këtë grupacion plotësisht i përshtaten këtij grupi, apo janë tërësisht të gatshëm për kalim.

Segmenti 2: Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim por që mund të përgaditen lehtësisht

Ndryshe nga pjesëmarrësit në Segmentin 1, ata të Segmentit 2 nuk janë plotësisht të gatshëm për kalim, por që sipas përgjigjeve të dhëna në anketim, mund të përgaditen lehtësisht.

Shumica e pjesëmarrësve të Segmentit 2 i kanë të gjitha parakushtet për të bërë tranzicionin. Ata janë individët të cilët:

- Mund të përballojnë koston e tranzicionit nga sistemi Analog në atë Digjital;
- I janë përgjigjur pyetjes C4.1. të pyetsorit, “A do të bëni blerjen e resiverit për pranin sinjali me kosto të përafert prej €30 - €50 apo do të bleni TV të ri?”;
- Kanë në plan ndërrimin e televizorit/njërit nga televizorët të cilët i posedojnë në tri vitet e ardhshme.

Pas tabulimit të të dhënave, është gjetur se 717, apo 42.3% e të anketuarve në këtë grupacion plotësisht i përshtaten këtij grupi, apo janë pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim, por që mund të përgaditen lehtësisht.

Segmenti 3: Pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim dhe që mund të përgaditen më vështirësi

Sikur pjesëmarrësit në Segmentin2, ata të segmentit 3 nuk janë të gatshëm për kalim. Megjithatë, ndryshe nga ta, Segmenti 3 ka shfaqur vështirësi në përgatitjen për të qenë të gatshëm për digjitalizim. Pjesëmarrësit në këtë segment kanë pasur tendencë për ta konsideruar këtë tranzicion si problem financiar dhe si një proces për të cilin do të mund të përgatiten me shumë vështirësi.

Pjesëmarrësit e Segmentit 3 kanë qenë individë të cilët:

- Nuk kanë televizorë digjital;
- Nuk mendojnë se mund të përballojnë koston e tranzicionit
- Instalimi është shumë i shtrenjtë për ta
- Kanë përmendur edhe barrierat tjera ndryshme në lidhje me instalimin digjital
- Kanë raportuar shkallë të ulët të shikimit të televizorit
- Nuk janë të mirë-informuar për tranzicionin në tërësi

Pas tabulimit të të dhënave, është gjetur se 190, apo 49.7% e të anketuarve në këtë grupacion plotësisht i përshtaten këtij grupi, apo janë pjesërisht apo jo të gatshëm për kalim dhe që mund të përgaditen më veshtirësi.

Segmenti 4: Jo të gatshëm për kalim dhe nuk e mbështesin kalimin në transmetim digjital

Pjesëmarrësit në segmentin 4 nuk janë të gatshëm për kalimin në transmetim digjital, që vështirë mund të përgaditen dhe të cilët nuk e mbështesin kalimin

Pjesëmarrësit e Segmentit 4 kanë qenë individë të cilët:

- Posedojnë televizorë analog,
- Nuk kanë në plan ndërrimin e televizorit/njërit nga televizorët të cilët i posedojnë në tre vitet e ardhshme.
- Nuk janë aspak të informuar për procesin e digjitalizimit
- Janë të kënaqur me sistemin e deritanishëm

Pas tabulimit të të dhënave, është gjetur se 122, apo 62,6% e të anketuarve në këtë grupacion plotësisht i përshtaten këtij grupi, apo janë jo të gatshëm për kalim dhe nuk e mbështesin kalimin në transmetim digjital.

Ndihmë shtesë për procesin e kalimit në transmetim digjital

Ndihmë financiare për procesin e digjitalizimit

Hulumtimi ka zbuluar se nga te gjithë pjesëmarrësit, 21.2% nuk mendojnë se mund të përballojnë koston e tranzicionit nga sistemi Analog në atë Digital, përderisa 30% e tyre nuk e dijnë nëse mund ta përballojnë apo jo. Poashtu, në pyetjen “Cila do të ishte barriera kryesore e juaja në lidhje me instalimin digjital?,” vetëm 13.1% e pjesëmarrësve në anketim mendojnë se ky instalim është shumë i shtrenjtë për ta, ndër të tjera barriera.

Sa i përket grupeve moshore të cilët kanë nevojë më të shprehur për mbështetje, pensionistët kanë paraqitur shkallë më të lartë të pamundësisë, me 68.2% të tyre që nuk mund ta përballojnë koston apo që nuk e dijnë nëse mundën. Në bazat etnike, 49.4% e pjesëmarrësve serb dhe 46.2% e atyre të komunitetit RAE kanë deklaruar se nuk mund ta përballojnë këtë tranzicion, si dy grupet etnike me nevojën më të theksuar për mbështetje financiare.

Sipas këtyre përgjigjeve mund të thuhet se nevoja për mbështetje financiare për procesin e digjitalizimit, megjithëse jo shumë e shprehur, është ende një faktor i rëndësishëm në përgatitjen e qytetarëve për këtë tranzicion.

Grafikët në vijim paraqesin statistikat e përgjigjeve të lartë-përmendura në nivele të ndryshme grupe.

Tabela 4: Statistikat mbi përgjigjen “Ky instalim është shumë i shtrenjtë për mua” si barrierë kryesore në lidhje me instalimin digjital.

	Statusi i punësimit:					Grupi Etnik:						
	18 – 28	I/e punësuar	I/e papunësuar	I/e pensionuar	Student/e	I/e paaftë për punë	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	RAE	Tjetër
Ky instalim është shumë i shtrenjtë për mua	12.4%	13.0%	14.9%	12.1%	9.2%	15.4%	13.8%	8.0%	25.0%	10.0%	17.3%	7.0%

Ndihmë teknike për procesin e digjitalizimit

Formë tjetër e mbështetjes, e cila shihet si e nevojshme për shkak të mungesës së njohurive mbi atë se çfarë duhet bërë për t’u përgaditur për digjitalizimin, është dhe ngritja e njohurive të qytetarëve mbi çështjet teknike me të cilat duhet të merren për këtë proces.

Nga pjesëmarrësit në anketim, një e katërta e tyre (25.9%) kanë deklaruar se nuk e dinë se çfarë duhet bërë për t’u përgaditur për digjitalizim. Nga këta, pjesëmarrësit nga grup

mosha 65+ (45.8%), ata të cilët janë të paaftë për punë (38.5%), dhe të intervistuarit e etnicitetit serb (41.1%) e boshnjak (67.1%) janë grupet të cilët kanë shfaqur mungesë më të theksuar të informacionit mbi çfarë duhet të bëhet për digjitalizim (shih grafikun më poshtë).

Vlen të përmendet se nuk ka pasur dallime të mëdha në përgjigjet për këtë pyetje prej korrespondentëve nga qytetet dhe fshatrat, me 25.1% në qytete dhe 26.6% në fshatra që janë përgjigjur me “Nuk e di”.

Grafikët në vijim paraqesin karakteristikat e ndryshme të të anketuarve të cilët i janë përgjigjur kësaj pyetje në këtë menyrë.

Tabela 5: Statistikat mbi të anketuarit të cilët nuk dijnë se çfarë duhet bërë për tu përgaditur për digjitalizim.

	Total	Moshë:				Statusi i punësimit:					Grupi Etnik:					
		18 – 28	29 – 44	45 – 65	mbi 65	I/e punësuar	I/e papunësuar	I/e pensionuar	Student/e	I/e paaftë për punë	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	RAE	Tjetër
Nuk e di	25.9 %	21.0 %	24.6 %	32.9 %	45.8 %	19.1 %	32.3%	45.6%	20.8%	38.5%	22.8 %	41.1 %	25.0 %	67.1%	19.2%	62.8 %

Sfidat

Mungesa e njohurive mbi procesin

